



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:108134

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06370487

P.nr.684/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Dardane Ismaili në lëndën penale kundër të pandehurit B.B., për shkak të veprës penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.4545/18 e datës 24.09.2019, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, me datë 30.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë me numër PP.II.nr.4545/18 e datës 24.09.2019 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

B... B... nga i ati I..., e ëma N..., i lindur me datë .... në Mitrovicë, tani me vendbanim në ....., Mitrovicë, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale që ka arritur me datë 07.01.2024.

II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

III. Pala e dëmtuar B... I... dhe Z...B... për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.4545/18 e datës 24.09.2019 kundër të pandehurit B.B. për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjyqtari e ka pranuar këtë lëndë më datë:02.09.2024 dhe pas ndërmarrjes së veprimeve dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se në këtë çështje ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Gjykata gjeti se vepra penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së është kryer ne vitin 2018 andaj rrjedhimisht vlejné dispozitat e Kodit (04/L-082) Penal të Republikës së Kosovës. Sipas Kodit Penal, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, e i cili është më i favorshëm për të pandehurin, vepra penale Sulmi është e paraparë në nenin 187 paragrafi 1 të KPRK-së për të cilën vepër është paraparë dënimi me burgim deri në tri (3) vjet.

Neni 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, përcakton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim. Ndërkaq, sipas nenit neni 107 paragrafi 1 të KPRK-së, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas paragrafit 8 përcaktohet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata, nga gjitha faktet dhe provat e lart cekura konstaton se me datë 07.01.2018 kur dyshohet se i pandehuri B.B. ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së këtë vepër penale kanë kaluar gjashtë (6) vite, që nënkupton se duke u bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së, në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur më 07.01.2024, ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me dispozitën e nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër për të cilën është akuzuar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka marr aktvendim me të cilin e ka hedhur aktakuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Aktvendimi mbi parashkrimin absolut është bazuar në kuptim të nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së, si dhe neni 357 të KPP-së, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, Gjykata ka vendosur për këto shpenzime në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, ku është paraparë se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata ka vendosur që të dëmtuarit t'i udhëzoj që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil, në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPP-së, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktvendimi

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, sipas nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenit 107 paragrafi 1 dhe 8 të KPRK-së, e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

GJYKATA E THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.684/2020, datë 30.10.2024

Gjyqtarja  
Dardane Ismaili

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi, palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit të Aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.